REPUBLIKA E SHQIPËRISË
**MINISTRIA E DREJTËSISË**
**DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PËRMBARIMIT**
**ZYRA PËRMBARIMORE KURBIN**

**Nr. 6106 Prot.** **Laç, me 03.12.2019**

**VENDIM SHPALLJE**
***(Lidhur me ekzekutimin e "Urdherit te ekzekutimit" te titullit ekzekutiv te debitorit)***

Ne Lac,sot me date 03.12.2019
Une,Mikeda Cenaj, me detyre Permbarues Gjyqesore prane Zyres Permbarimore Kurbin, pasi studiova aktet proçeduriale te çeshtjes permbarimore Nr 686 rregjistri themeltar te vitit 2019 bazuar ne Urdherin e ekzekutimit te dates 25.10.2019 te Prokurorise se Rrethit Gjyqesor Kurbin,

**KONSTATOVA:**

Se ne date 11.11.2019 eshte depozituar prane Zyres se Permbarimit kerkesa e kreditorit Prokuroria e Rrethit Gjyqesor Kurbin se bashku me "Urdherin e Ekzekutimit" te Titullit Ekzekutiv (vendim gjyqesor penal) nr. 1169-158 te dates ... 2019 te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Kurbin,me pale dhe objekt:
-Kreditor: Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Lezhe
-Debitor: Aurel Haxhi Hasani i dtj. 25.01.1997 me banim ne Katund i Ri,Mamurras .
-Me objekt:Pagim shpenzime proceduriale, tarifat fikse permbarimore.

Nga ana e zyre tone permbarimore kane filluar procedurat ne baze te nenit 515 e vijues te K.Pr.Civile si dhe ligjit 8730 date 18/01/2001 "Per Organizimin dhe Funksionimin e Sherbimit Permbarimor Gjyqesor"i ndryshuar per ekzekutimin e detyrueshem te Titullit Ekzekutiv te sipercituar.

Nga verifikimi i kryer nga ana jone ne bashkepunim me organet kompetente rezulton se debitori Aurel Haxhi Hasani i dtj. 25.01.1997 nuk mund te njoftohet nepermjet sherbimit postar dhe si rezultat I kesaj bazuar ne nenin 133/a ,133/b dhe 144/a si dhe 517 te K.Pr.Civile duhet te behet njoftimi me shpallje publike I debitorit lidhur me detyrimin qe ai ka ndaj pales kreditore Prokuroria Rr.Gj. Kurbin per shpenzimet proceduriale dhe tarifat fikse permbarimore ne masen 2000 leke.

Sa me siper ne mbeshtetje te Nenit 133/a, 133/b dhe 144/a si dhe 517 te Kodit Procedures Civile, ligjit Nr.8730 date 18/01/2001"Per Organizimin dhe Funksionimin e Sherbimit Permbarimor Gjyqesor",i ndryshuar

**VENDOSA**

**1**-Te kryej njoftimin nepermjet shpalljes publike me afat 20 (njezet) ditor (duke mare parasysh edhe komunikimin postar) nga data 03/12/2019 deri ne .../12/2019 te debitorit Aurel Haxhi Hasani i dtj. 25.01.1997 me banim ne Katund i Ri,Mamurras.

**2**-Ky vendim perpilohet ne disa kopje,ku nje kopje afishohet ne vendbanimin e fundit te pales debitore,nje kopje afishohet ne kendin e njoftimeve te kesaj zyre, nje kopje dergohet per afishim ne ambjentet e Njesise Administrative te Bashkise ..., nje kopje dergohet per afishim ne ambjentet e Gjykates se Rrethit Gjyqesor Kurbin dhe nje kopje dergohet per publikim ne faqen zyrtare te Drejtorise se Pergjithshme te Permbarimit Tirane.

**3**-Kjo shpallje publike ka vieren e aktit te njoftimit per palen debitore Aurel Haxhi Hasani i dtj. 25.01.1997 me banim ne Katund i Ri,Mamurras.

**4**-Pala debitore Aurel Haxhi Hasani i dtj. 25.01.1997 me banim ne Katund i Ri,Mamurras,duhet te paraqitet prane Zyres Permbarimore Kurbin me seli ne Lgj nr.4,Lac ne katin e pare ne ambjentet e Gjykates se Rrethit Gjyqesor Kurbin dhe te hyje ne kontakt me permbaruesin gjyqesor te ceshtjes permbarimore per t'ju vene ne dispozicion aktet permbarimore,pasi me kalimin e ketij afati do te vijohet me ekzekutimin e detyrueshem sipas parashikimeve te nenit 519 e ne vijim te K.Pr.Civile.

U shpall,sot me date 03.12.2019

**PERMBARUESI GJYQESOR**
**MIKEDA CENAJ**